

RAPORTI I PUNËTORISË-SHESHI 7 KORRIKU

Projekti

“Qytetet Gjithëpërfshirëse”

Përgaditur nga

Artnet Haskuka

Dhjetor 2017



PËRMBAJTJA

1. HYRJA
2. SYNIMI DHE OBJEKTIVAT SI DHE PROCESI I DIZAJNIMIT TË HAPËSIRËS SHESHI 7 KORRIKU
3. PALËT E INTERESIT
4. METODOLOGJIA E APLIKUAR
5. HULUMTIMI DHE REZULTATET E HULUMTIMIT
6. SKENARI SIPAS REZULATEVE TE HULUMTIMIT - SHESHI 7 KORRIKU DHE PUNËTORIA E KONFIRMIMIT TË SKENARIT
7. KONLUZIONET


1. HYRJA

"Qytetet Gjithëpërfshirëse" është projekt ku bëhet promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban. Në kuadër të këtij projekti është paraparë të trajtohet hapësira e cila ndodhet në qendër të Prizrenit " Sheshin 7 Korriku". Në mënyrë që trajtimi i hapësirës të jetë i suksessheëm paraprakisht është bërë një hulimtim ku janë intervistuar grupe të ngrushmë të interesit. Ky hulumtim si aktivitet ka paraprirë hartimit të skenarit për hapësirën Sheshi 7 Korriku, i cili ka identifikuar mangësite, përparësitë si dhe arsyet se pse hapësira nuk vizitohet përkundër potencialit që posedon. Në vazhdim të këtij reporti do jipen në mënyrë detale të githa informatat relevante për këtë aktivitet.

2. SYNIMI DHE OBJEKTIVAT SI DHE PROCESI I DIZAJNIMIT TË HAPËSIRËS SHESHI 7 KORRIKU

Duke pasur parasysh që Sheshi 7 Korriku është hapësirë jo e integruar në sheshin Shadërvan dhe posedon një numër të madhë të lokaleve që janë të mbyllura është vendosur që të ndërmirren hapa dhe hapësira të trajtohet në mënyrë specifike. **Synimi ishte vlerësimi i veprimeve që duhet të bëhen për krijim të ndryshimeve pozitive në zhvillimin e qëndrueshëm të hapësirës me një proces transparent ku përfshihen të gjitha grupet e interesit.** Si objektivë specifike është ndërtimi i dialogut mes institucioneve dhe pronarëve/bizneseve që veprojnë në atë pjesë, dhënya e “pronësisë” pronarëve/bizneseve që veprojnë në atë hapësirë si dhe përfshirja e të gjitha grupeve të marginalizuara në process të planifikimit.

Për një process sa më transparent dhe përfshirje të propozimeve nga pronarët, profesionistët, qytetarët etj në dizajn është paraparë që procesi i hartimit të dizajnit të kalojë në disa faza. Këto faza janë paraqitur në mënyrë skematike në vazhdim.



Dizajni i projektit duhet të kalojë në dy faza kryesorë:

Faza 1- Hartimi i KONCEPTIT të projektit i cili përfshin: inicimin e projektit, hulumtimin/anketimin në teren, analiza e të dhënavë, skenari i mundshëm dhe hartimi i konceptit për dizajn. Kjo fazë është inicuar dhe finalizohet nga OJQ EC Mandryshe.

Faza 2 – DIZAJNIMI i projektit përfshin: matjet në terren, dizajnin e hapësirës, konfirmimi i dizajnit dhe prezentimi publik. Parashihet që me këtë fazë të merret organizata apo institucioni që do të financojë edhe vetë projektin.

3. PALËT E INTERESIT

Ky aktivitet konsiderohet të jetë i rëndësisë së veqantë dhe është obligim që del nga LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR.

Analiza e pjesëmarrësve për këtë projekt ka qenë proces dinamik i cili ka ndihmuar në identifikimin e legjimititetit, interesit dhe rolit të secilit pjesëmarrës në proces. Kujdes i posaçëm është dhënë involvimit të grupeve të ndjeshme si ato të femrave, të moshuarve dhe të rinjëve, të gjitha pakicave etnike dhe atyre me me nevoja të veqanta.

Involvimi i palëve në proces ka kërkuar edhe përbushjen e disa kritereve të rëndësishme si në vijim:

- Partneritetit; duke përdorur qasjen e partneritetit ata duhet të punojnë së bashku
- Udhëheqjes; në mënyrë që të tekalohen sfidat dhe të sigurohet rezultati në punë ata duhet të kenë aftësi udhëheqëse
- Vazhdimesia; është thelbësore tek partneriteti dhe udhëheqja në mënyrë që të sigurohet strategja afatgjate
- Ndarja e vizionit; vizioni duhet të ndahet edhe më gjerë
- Implementimi i veprimeve; ata duhet të sigurojnë zbatimin e veprimeve që do të dalin nga ky projekt.

Pas analizës së individëve se a plotësojnë kriteret e lartëpërmendura, a ndikohen në mënyrë direkte, a kanë interes në çështjet specifike dhe se sa kanë ndikim, a kanë qasje apo kontroll mbi burimet (financiare, teknike, intelektuale) përfaqësuesit janë grupuar në:

PALËT KYÇE

- PRONARET/BIZNESET – është grapi që punon dhe vepron në atë pjesë
- TEQJA – është pjesë e sheshit 7 korriku
- KOMUNA E Prizrenit – institucion që konsiderohet një ndër financuesit më potencial për këtë hapësirë

PALËT SEKONDARË

- PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE – organizatat që veprojnë në Prizren duke përfshirë edhe grupet e marginalizuara
- BANORE – familjet që jetojnë afér Sheshit 7 Korriku
- RINIA – grupet e caktuara që frekuentojnë Sheshin 7 Korfiku
- PROFESIONISTË / ARKITEKTË që jetojnë dhe veprojnë në Prizren



Duhet theksuar se rëndësi të veçantë ka pasur edhe mënyra e mobilizimit të tyre pra kur dhe në cilën fazë duhet të përfshihen ata. Palët kyq kanë qenë të përfshirë prej fillimit deri në finalizim të skenarit ndërsa palët

sekondarë kanë qenë të angazhuar në pjesën e hulumtimit dhe disa përfaqësues janë përfshirë edhe në punëtori. Përfshirja e palëve te intereset ka reflektuar me një proces transparent dhe njëherit edhe me ndërtim të një koncensusi për një projekt i cili është interes i përbashkët.

Pas këtyre dy fazave pason implementimi i projektit që gjithashtu është fazë në veti me pjesëmarrje është organizuar hulumtimi dhe punëtoria për hartimin e skenarit.

4. METODOLOGJIA E APLIKUAR


Për finalizim sa më të suksesshëm të aktivitetit jemi përcaktuar në përdorimin e metodologjisë së kombinuar me hulumtim dhe punëtori. Kombinimi i këtyre dy aktiviteteve ka rezultuar me përfshirje më të gjërë të palëve dhe jo vetëm por edhe në mbledhjen e informatave nga terreni.

Hulumtimi ka përfshirë institucionet, banorët, qytetarë etj në proces. Aktiviteti i cili konsiderohet të jetë i suksesshëm ka identifikuar mangësite, përparrësitë si dhe arsyet se pse hapësira nuk vizitohet përkundër potencialit që posedon. Duhet të theksohen se ky aktivitet ka rezultuar edhe me një sërë propozimesh duke filluar nga materiali që duhet të përdoret për shtruarje deri tek elementet mikro-urbane që mund të përdoren në këtë hapësirë. Të gjitha propozimet kanë reflektuar në një skenar të mundshëm që është prezantuar në punëtori dhe diskutuar deri në detale.


5. HULUMTIMI DHE REZULTATATET E HULUMTIMIT

Më lartë është cekur se hulumtimi ka pasur një rol të veqantë në tërë procesin e hartimit të skenarit për Sheshin 7 Korriku ku kanë qenë të përfshirë rrëth 70 individë që kanë përfaqësuar grupet e ndryshme të interesit. Si vegël për hulumtimit janë përdorë pyetësorët me pyetje që kanë qenë të hapura dhe të mbyllura ku është ofruar mundësia secilit intervistues të jep mendim të pamvaruar.

Gjatë intervistimit është kushtuar vëmëndje e veqantë që të përfshihen të gjitha grup moshat, gjë që vërehet edhe në diagramin e mëposhtëm ku mbi 50vjet kanë qenë 43% të intervistuarëve ndërsa afërisht gjysma tjetër kanë qenë grup moshat 15-20, 20-35 dhe 35-50 vjeçarë. Involvimi i të dy gjinive ka pasur rëndësi për arsy se pikëpamjet e tyre për zgjedhjen e problemeve janë të ndryshme.




Ka qenë shumë me rëndësi të identifikohet se sa shfrytezohet kjo hapësirë dhe pse nuk shfrytëzohet. Rezultatet kanë treguar se hapësira e Sheshit 7 Korriku në përgjithësi është e pashfrytëzuar, pra vetëm 57% përdor 15-30 minuta gjë që është shfrytëzueshmëri shumë e ulët. Është pyetur edhe arsyja e mos shfrytëzimit ku 93% kanë thënë se kjo hapësirë nuk pëlqehet nga ana e tyre.



Në mënyrë që të kemi propozime më të qëndrueshmë ishte me rëndësi të identifikojë mangësitë e Sheshit 7 Korriku. Ato radhiten si në vijim:

- Hapësirë e ngulfatur me tavolina dhe tenda
- Zhurmë
- Nuk është atraktive dhe nuk janë përdorë materiale adekuate në dysheme
- Nuk ka qasje për persona me nevoja të veqanta
- Nuk ofron siguri për shkak të mungesës së ndriqimit (përdorimi I narkotikëve ne vendet e errëta)
- Nuk ofron përbajtje të përshtatshme apo rehatshme për të gjitha moshat por më tepër për të rinjtë
- Mungesa e gjelbërimit
- Hapësira publike të uzurpuara (me rrethoja-xhamë, gjeneratorë, kontenierë tek VIVA)
- Laramania në fasada
- Kanalizimi jofunksional

Hulumtimi nuk ka injoruar edhe materialin e shtruar, ku 86% kanë thënë që nuk është adekuat, kurse vetëm 14% kanë thënë që materiali adekuat. Po ashtu intervistuesit kanë propozuar edhe materiale që mund të përdoret në këtë pjesë. Numri më I madhë I intervistuesve ka thënë që graniti (kubëzat e Shatërvanit) është material që mund të përdoret në mënyrë që të kemi vazhdëmisë të Sheshit Shatërvan në këtë pjesë.



Hulumtimi ka dhënë hapësirë që intervistuesit të propozojnë zgjidhje për këtë këtë hapësirë. Kemi një listë të propozimeve që kanë dhënë grupe të ndryshme:

- Përdorimi-shtruarja me material natyror-kubëza të granitit (në tërë hapësirën)
- Largimi i tendave individuale dhe vendosja e tendës së përbashkët (nëse është e domosdoshme)
- Të shtohet ndriqimi
- Të rrafshohet dyshemeja dhe te shtohen rampat
- Dukja unike (fasada) conform ligjit per Zone te mbrojtur
- Të shtohet gjelbërimi
- Punimet nëntokësorë- punët e ujut dhe kanalizimit
- Të shtohen edhe përbajtje për prodhimin apo shitjen e produkteve artizanale që të jetë térheqës për të gjitha moshat
- Ky kompleks të jetë një hapësirë me përbajtje të aktiviteteve që kryesisht pëlqehen nga mosha rinore dhe e mesme, meqenëse zonat përreth përdoren dhe frekuentohen nga të gjitha moshat
- Ri-organizmi i tavolinave (ndarja proporcionale e hapësirës) dhe mundësimi i qarkullimit të lirë
- Shtimi i kontenjerëve

6. SKENARI SIPAS REZULATEVE TE HULUMTIMIT - SHESHI 7 KORRIKU DHE PUNËTORIA E KONFIRMIMIT TË SKENARIT

Gjatë analizës së informatave nga hulumtimi si pikënisje janë marre problemet dhe janë identifikuar vendet e tyre në kuadër të Sheshit 7 Korriku.




Fig. 1 Ortofoto (viti 2004) e Sheshit 7 Korriku

Në ortofoto shihet që casja në Sheshin 7 Korriku mund të bëhen nga katër anët. Në tërë hapsirën vërehet një laramani si në material të shtruar po ashtu edhe në fasada. Në hulumtim ceket se hapësira është e ngulfatur me tenda dhe tavolina dhe lëvizja për persona me nevja të veganta është e pamundur. Për adresimin e problemeve të lartësekura dhe hartim të një skenari të mundshëm janë marre parasysh propozimet dhe të gjitha rezultatet nga hulumtimi. Në vijim janë propozuar elemente me përdorimin e të cilave mund të përmirësohet cilësia e hapësirës dhe mund të bëjë këtë hapësirë vend të dëshirueshëm për argëtim apo socializim.





Fig. 2 Elementet që mund tē përdoren

Të gjitha këto elemente janë inkorporuar në menyrë skematike në vizatimin e mëposhtëm. Nëse analizohet vizatimi atëherë mund tē vërehet se është propozuar ndërimi i kanalizimit dhe shtrimi i hapesirës me gurë graniti në menyrë që kjo hapësirë tē jetë e integruar në Shatërvan. Mungesa e gjelbërimit është vështirë tē adresohet në një hapësirë tē tillë, por përdorimi i mureve të gjelbëruara sado pak kishte me gjallëru hapësirën. Cështja e sigurisë është mbi të gjitha dhe këndet e errësuara duhet tē ndriqohen në menyrë që tē pamundësohet përdorimi i narkotikëve nga grupet e ndryshme. Mungesa e ndriqimit vërehet tek hyrja perëndimore (tek rrobaqepësi) dhe para teqes ku propozohet tē shtohet ndriqimi si dhe tē kemi një kënd për socializim, shtim tē gjelbërimit si dhe prania e muralit do tē jepte gjallëri në këtë pjesë. Sigurimi i vendeve për socializim ka qenë i rëndësisë së vegantë dhe është propozuar që kjo tē bëhet para SHKA Agimi

Në menyrë që hapësira tē frymojë është propozuar që tē largohen tendat dhe nëse është e domosdoshme tē vendoset tenda e përbashkët.




Fig.3 Skenari i mundshëm i Sheshit 7 Korriku

Propozimet e mureve të gjelbëruar



Propozimet për hapësirën para Teqes



Skenari dhe të gjitha këto propozimet janë diskutur në një punëtori ku kanë qenë prezent pronarët/bizneset, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues të shoqërisë civile etj të cilët e kanë mirëpritur iniciativën për këtë pjesë. Pjesëmarrësit janë pajtuar me skenar dhe janë shprehur që mund të vazhdohet me projekt detal. Përveq tjerash është diskutuar edhe unifikimi i fasadave në bazë të parametrave që dalin nga Plan i Konzervimit dhe Zhvillimit për qendrën Historike të Prizrenit.



7. KONLUZIONET

Faza e parë, hartimi i konceptit për Sheshin 7 Korriku është finalizuar. Ky raport përfshin mangësitë, propozimet dhe mund të merret për bazë gjatë hartimit të projektit detal. Mund të konkludojmë që rapporti është produkt i përfshirjes së të gjitha palëve të ineteresit dhe mund të shërbejë edhe si shembull për projekte tjera që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit me një proces transparent. Informimi dhe involvimi i të gjitha grupeve që nga fillimi i procesit do të rezultojë me transferim të "pronësisë" së projektit tek qytetarët. Në momentin që ata ndihen pronarë të hapësirisë atëherë edhe mirëmbajtja do të jetë më e kënaqshme. Propozohet që gjatë hartimit të projektit detal, dizajni të dakordohet me grupe të interestit. Nëse mirret iniciativa për regjenerim të fasadave atëherë propozohet që kjo të bëhet nga një grup profesionistësh që përfaqësojnë organizata dhe institucione që veprojnë në Prizren dhe gjithnjë në bashkëpunim me pronarë.